



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 11 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi, Liburn Aliu, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Ervin Ibrahimit- UNDP, Flora Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit,**
- 3. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit

Fikrim Damka- Tha se stafi e ka përgatitur raportin e punës së Komisionit. Është bërë një punë e mirë. Nëse keni diçka për të shtuar në raport, do ta plotësojmë me propozimet

tuaja. Tashmë kanë arritur edhe dy projektligje të tjera. Shpresoj se viti 2012 do të jetë më i suksesshëm se viti 2011. Kemi pasur mangësi sa u përket vizitave në terren, ndërsa në këtë vit do të orientohemi të bëjmë më shumë vizita në terren, konkretisht në spitale regjionale.

Nazane Breca- Deklaroi se kam vërejtje për mospërfshirjen e emrit tim në grupin e punës për Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve. Besoj se është ndonjë gabim teknik, i cili do të përmirësohet.

Salihe Mustafa- Tha se kam një vërejtje aty ku thuhet se kryetari dhe nënkryetari kanë pasur një takim me shoqatat e pensionistëve dhe me përfaqësuesit e sindikatës e për të cilat takime, me sa di unë, nuk është raportuar në Komision.

Liburn Aliu- Deklaroi se meqenëse kam ardhur vonë si anëtar i Komisionit, konstatoj se raporti, më konkretisht, pjesa e raportit që përfshin periudhën kohore të anëtarësisë sime në Komision është në rregull.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri vendosi ta miratojë Raportin e punës së Komisionit për vitin 2011.

3. Të ndryshme

Fikrim Damka- Tha se sot e kam pasur një takim me përfaqësues të UNDP-së dhe ata kanë shprehur gatishmërinë e tyre për ta mbështetur Komisionin në procesin e hartimit të ligjeve. Po ashtu, ata janë të gatshëm ta organizojnë një punëtori (takim pune) lidhur me amendamentimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Ne, si Komision, kemi vendosur ta bëjmë një vizitë në Turqi dhe kjo do të fillojë më datën 16 janar 2012.

Pas informimit nga ana e kryetarit, Komisioni vendosi ta mbajë një punëtori për Ligjin për shërbime sociale dhe familjare.

Flora Brovina- Deklaroi se duhet të bëjmë monitorimin e decentralizimit të buxhetit në shëndetësi. Pra, në planin e punës ta parashohim këtë monitorim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka